

## TERMA REFERENCE

### TITULLI PROJEKTIT

Ndërtim puseve dublikant , rrethim dhe pastrim të puseve ekzistues në zonën e shërbimit të shoqëris rajonale UK Durrës (me çelësa në dorë)

### PËRFITUESI

Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Durres

### AUTORITETI KONTRAKTOR

Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Durres

### 1 HYRJE

Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Durres furnizohet me ujë nga 4 burime nentokesore uji, me ngitje mekanike dhe 3 burime natyrore me vete rrjedhje:

- ✓ Burim Fushë Kuqe, me kapacitet 810 l/sek
- ✓ Burimi Fushë Krujë, me kapacitet 160 l/sek
- ✓ Burimi Fushë Milot, me kapacitet 630 l/sek
- ✓ Burimi Çërme, me kapacitet 300 l/sek
- ✓ Burimet e Krujes 30 l/sek

Me anë të të cilave furnizohet me ujë Bashkia Durres, Bashkia Shijak, Bashkia Kavaje, Bashkia Kruje, Bashkia Rrogozhine, dhe pjesërisht Bashkine Vore, Nj.Adm.Fushë Kuqe dhe Nj.Adm.Bubq.

### 2 HISTORIKU DHE SITUATA AKTUALE

**Burimi Fushe Kuqe** ndërtuar në vitin 1976 dhe rikonstruktuar ne vitin 2005, ka në shfrytëzim 9 pus-shpime, në të cilat në tre prej tyre përdoren dhe pusët dublikate te vitit 1976. Nga inspektimi është konstatuar se 2 puse jane jashte funksionit dhe se kollonat e tyre jane të shembura, duke bërë që në më shume se 2 vite nuk merret uje prej tyre. Kjo gjë ka reflektuar tek regjimi i venies ne punë të puseve duke mos rrespektuar kushtet teknike të projektimit si dhe në reduktim të sasisë së ujit të prodhuar nga ky burim. Për këtë arsye nevojitet të merren masa urgjente për ndërtimin e dy pus-shpimeve të reja në këtë burim dhe pastrimin e dy puseve ekzistuese të cilat nuk janë pastruar që prej vitit 2005.

**Burimi Fushë Krujë** ndërtuar në vitin 1989, ka në shfrytëzim 5 puse uji, në të cilat 2 prej tyre janë të dublikuar. Nga inspektim është konstatuar se 1 pus i pastruar para 3-viteve, ka carje të kollonës dhe deformin të saj. Sot ai shfrytëzohet në kapacitet jo të plotë dhe vetëm në raste emergjente. Kërkohet që të bëhet ndërhyrje sa më shpejt, në ndërtimin e një pusi të ri dublikant dhe pastrimin e pusit ekzistuese të ndërtuar në 2017. Kjo gjë do të bëjë të mundur që të realizohet prodhimin i kërkuar nga ky burim, që furnizoh me ujë Bashkinë Shijak dhe disa biznese që kryejnë aktivitet pranë tubacionit kryesor të këtij burimi.

**Burimi Çermës** ndërtuar në vitin 2010, ka në shfrytëzim 7 puse uji. Nga inspektimi është konstatuar se pusi nr.6, nuk funksionon pasi ka shëmbje. Gjithashtu dhe pusi nr.7 ka shëmbje dhe uji që prodhohet nga ky pus është jo cilesor, duke bërë që gjatë këtij sezoni të kemi mungesë furnizimi me ujë për qytetet Rrogozhinë, Kavajë dhe zonën turistike të Golemit. Kërkohej të bëhet pastrimi i 5 puseve ekzistuese me qëllim që të rritet sasia e ujit të prodhuar prej tyre, si dhe ndërtimi i 2 puseve të reja duke bërë që të sigurohet rregjim sa më të mirë të stacionit të pompimit Çermë si dhe furnizim me ujë të zonave që furnizohen nga ky burim.

**Burimi Fushë Milot** ndërtuar në 2019, operon brënda kushteve teknike duke siguruar sasinë e projektuar prej 630 l/sek ujë. Evidentohen vetëm disa problematika elektro-mekanike të e-pompave, për të cilat shoqëria do marrë masa për riparimin e tyre.

**Burimet e Krujes** janë ndërtuar në vitet 1980 dhe shërbejnë për furnizim me ujë të qyteti Krujë dhe fshatave përreth. Nga inspektimi është konstatuar se gjendja e burimeve është jo e mirë dhe mungojnë rrethimi i zonës së parë të mbrojtjes S1. Burimet e Krujes përbehen nga burimet e Livallas, Sakarrac, Llaspot dhe Depo Nr.1 Varrosh, Depo Nr.2 Perlat, Depo Nr.3 Gurakuq, Depo 4-5 Qender, Depo Nr.6 Isake dhe Rezervuari 7 Abaze të cilat kanë nevojë emergjente për rrethim rikonstruksion dhe vend roje.

## **OBJEKTIVI DHE QËLLIMI**

Objektivi kryesor i këtij projekti është rritja e sasisë së ujit në kaptazhet e zonës së shërbimit të Shoqërisë Rajonale Ujesjelles Kanalizime Durrës dhe permisimi i kushteve higjieno-sanitare në rezervuaret dhe kaptazhe.

- **Ndërtimi i dy puseve dublikant në Fushe Kuqe,**
- **Pastrimi i pesë puseve ekzistuese dhe ndërtimi i dy puseve të reja në Çermë,**
- **Ndërtimin e një pusi të ri dublikant dhe pastrimin e pusit ekzistues në Fushë Krujë,**

Objektivi i dytë kryesor është permisimi i kushteve higjieno-sanitare në rezervuaret dhe kaptazhe në përputhje me standardet mjedisore dhe shëndetësore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Referuar Vendim nr. 379, datë 25.5.2016 për miratimin e rregullor “Cilësia e ujit të pijshëm” Shtojca VI. Mbrojtja sanitare e burimeve të ujërave nëntokësore (Për furnizim publik ose individual).

- **Rrethim i zonës së parë të mbrojtjes S1 të burimeve të Livallas, Sakarrac, Llaspot dhe Depo Nr.1 Varrosh, Depo Nr.2 Perlat, Depo Nr.3 Gurakuq, Depo 4-5 Qender, Depo Nr.6 Isake dhe Rezervuari 7 Abaze.**
- **Rikonstruksion dhe vend roje për Depo Nr.1 Varrosh, Depo Nr.2 Perlat, Depo Nr.3 Gurakuq, Depo 4-5 Qender, Depo Nr.6 Isake dhe Rezervuari 7 Abaze.**
- **Vend roje për depo Gjiri i Lalezit, Depon e re Arapaj dhe Depo Nr.2/1 .**

**Ky projekt pilot, do të përfshijë fazat si më poshtë vijon:**

- **FAZA I Projekt ide;**
- **FAZA II Projekt i zbatimit;**
- **FAZA IV Realizimi i punimeve të ndërtimit;**

### **3 FAZAT E REALIZIMIT TË PROJEKTIT**

Projekti për objektin: “Ndërtim puseve dublikant , rrethim dhe pastrim të puseve ekzistues në zonën e shërbimit të shoqëris rajonale UK Durrës” – projekt zbatimi dhe realizim i punimeve të zbatimit, duhet të kalojë në këto faza:

**FAZA I Projekt ide paraprake (Përgatitja e projektit dhe planifikimit), Përpunimi i pjesëve të rëndësishme të një zgjidhjeje të detyrës së planifikimit, e cila do paraqitet në jo më pak se 2 variant- propozime, ku për secilin variant do të dorëzohen:**

- a. Vizatimet teknike (planimetri e përgjithshme, planvendosja, projekti teknik, relacion paraprak hidrogeologjik.
- b. Relacion teknik (mbi ndërhyrjet e parashikuara)
- c. Preventiv paraprak;

#### **FAZA II Projekt i zbatimit**

##### **Detajimi i të gjithë projekteve përkatëse për realizim**

Projekti i zbatimit duhet të përmbajë: Vizatimet duhet të paraqiten në format A3 ose më të madh, të jenë të lexueshme dhe të përmbajnë si minimum fletët si më poshtë:

1. Topografinë e gjendjes ekzistuese në të cilën të jenë të azhornuara (me leje dhe pa leje)
2. Planvendosjen e objektit në Shk 1:100
3. Planimetria e përgjithshme e objektit në Shk. 1:200; 1:500
4. Koorografine në shkallë 1:25 000. (1:10 000)
5. Projekt Hidrogeologjik per ndertimin e pusev dublikant
6. Projekt ndertimi per rikonstuksionin e depove, rrethimin e depove dhe kaptazheve.
7. Profila gjatesorë dhe tërthorë
8. Detaje dhe hollësi të ndryshme
9. Llogaritjet hidraulike
10. Llogaritjet konstruktive
11. Përshkrimi i gjëndjes së trasesë.
12. Projekt preventivi të bëhet konform KTP dhe VKM nr.629 dt.15.07.2015 “Manuali i çmimeve të ndërtimit”, shoqëruar me analizat përkatëse.
13. Planimetria e murit rrethues Shk.1:100; 1:50.

##### **Relacionet shoqëruese**

1. Vlerësimi i Ndikimit ne Mjedis
2. Raport teknik
3. Raport hidro, kush, kuz
4. Raport konstruktiv+ llogaritjet e strukturës
5. Preventivi i zbatimit
6. Rilevimi
7. Studimi Hidrogeologjik
8. Grafiku i punimeve
9. Licensat e stafit projektues
10. Deklaratat e stafit pjesëmarrës në hartimin e projektit.

***Materialet dorëzohen ne Sh.R Ujesjelles Kanalizime Durres në format hard copy (të printuar) dhe cd në formate soft copy (cad, excel, word etj...)***

#### **FAZA III Zbatimi i punimeve të ndërtimit (me çelësa në dorë)**

I gjithë dokumentacioni i duhur dhe aplikimi për leje ndërtimi do të kryhet nga operatori ekonomik fitues në bashkëpunim me autoritetin kontraktor. Aplikimi për të gjithë procedurën e marrjes së lejes do të kryhet online nga operatori ekonomik fitues.

## ***Faza e aplikimit pranë bashkisë ku bën pjesë godina do të jetë marrja e lejes së ndërtimit.***

Dokumentet që duhet të paraqesë zhvilluesi (subjekti fitues) për t'u pajisur me leje ndërtimi janë:

- Dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet midis pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta;
- Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese;
- Projekti i ndërtimit dhe relacioni përkatës;
- Grafiku paraprak i punimeve dhe afati i dorëzimit të objekteve, sipas fazave të zbatimit;
- Preventivi i zbatimit;
- Deklarata e projektuesit të licencuar, sipas formatit të aplikimit, të përcaktuar në sistemin elektronik të lejeve të ndërtimit, nëpërmjet së cilës konfirmohet përputhshmëria e projektit me lejen e zhvillimit, dokumentet e planifikimit e kontrollit të zhvillimit, në fuqi, dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dispozitat antisizmike, të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri dhe higjieno-sanitare;
- Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit;
- Mandatpagesa/t e tarifës/tarifave të aplikimit;
- Kopje e policës së sigurimit të projektuesve, për mbulimin e përgjegjësive profesionale.

Projekti i zbatimit do të hartohet në përputhje me kushtet e përcaktuara në lejen e zhvillimit/dokumentet e planifikimit dhe në bazë të tij lëshohet leja e ndërtimit.

## **4 STAFI I KËRKUAR PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT TË PLOTË TË ZBATIMIT**

**Staffi që kërkohet për realizimin me sukses të këtij projekti duhet të përfshijë:**

- *Inxhinier Gjeolog /Hidrogjeolog*
- *Inxhinier Hidroteknik*
- *Inxhinier Nertimi*
- *Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshaider*

Për realizimin e projekt idesë dhe projektit të plotë të zbatimit është parashikuar një periudhë 30 ditore nga dita e lidhjes së kontratës, ndërsa periudha për realizimin e punimeve për ndërtimin e objektit do të jetë 150 ditë nga data e lirimi të sheshit të ndërtimit.

## **5 PARAQITJA E VIZATIMEVE**

Të gjitha vizatimet e projektit të zbatimit duhet të paraqiten në formatin që projekti dhe detajet teknike të jenë në shkallën e duhur për tu paraqitur sa më qartë për fazën e zbatimit.

## **6 RAPORTIMI DHE DORËZIMI FINAL**

Raportet dhe dokumentat duhet të jenë në 3 (tre) kopje me ngjyra, në gjuhën shqipe. Vizatimet duhet të jenë të lexueshme në formatin “dwg” (AutoCad). Të gjitha materialet do të dorëzohen edhe në soft-copy (në 2 CD).

## DETYRË PROJEKTIMI

**OBJEKTI:** *Ndërtim puse dublikant, rrethim dhe pastrim te puseve ekzistuese në zonën e shërbimit te shoqerise Rajonale UK Durres (me çelësa në dorë)*

**VENDNDODHJA:** Fush Kuqe, Fush Milot Fushe Kruje, Çermë dhe burimet e Krujes

**Qëllimi:** Qëllimi i këtij projekti është:

- 1-Përmirësimi i furnizimit me ujë në zonen ku furnizohen nga keto burime
- 2-Hartim i Projekt Zbatimit ndertimin e puseve dublikant dhe rrethim e objekteve per zonen e rreptesis S1
- 2-Hartimi i raportit Hidrogjeologjik per ndertimin e puseve dublikant
- 3-Përmirësimi i ciëlsisë së ujit conform VKM nr.379 dt.25.5.2016

**Të dhënat kryesore:**

- 1-Skicë-Ideja e hartuar nga shoqëria UK Durrës

**Përshkrimi i shkurter i gjëndjes:**

**Burimi Fushe Kuqe** ndërtuar në vitit 1976 dhe rikonstruktuar ne vitin 2005, ka në shfrytëzim 9 pus-shpime, në të cilat në tre prej tyre përdoren dhe puset dublikate te vitit 1976. Nga inspektimi është konstatuar se 2 puse jane jashte funksionit dhe se kollonat e tyre jane të shembura, duke bërë që në më shume se 2 vite nuk merret uje prej tyre. Kjo gjë ka reflektuar tek regjimi i venies ne punë të puseve duke mos rrespektuar kushtet teknike të projektimit si dhe në reduktim të sasisë së ujit të prodhuar nga ky burim. Për këtë arsye nevojitet të merren masa urgjente për ndërtimin e dy pus-shpimeve të reja në këtë burim dhe pastrimin e dy puseve ekzistuese të cilat nuk janë pastruar që prej vitit 2005.

**Burimi Fushë Krujë** ndërtuar në vitin 1989, ka në shfrytëzim 5 puse uji, në të cilat 2 prej tyre janë të dublikuar. Nga inspektim është konstatuar se 1 pus I pastruar para 3-viteve, ka carje të kollonës dhe deformin të saj. Sot ai shfrytëzohet në kapacitet jo të plotë dhe vetëm në raste emergjente. Kërkohet që të bëhet ndërhyrje sa më shpejt, në ndërtimin e një pusi të ri dublikant dhe pastrimin e pusit ekzistuese të ndërtuar në 2017. Kjo gjë do të bëjë të mundur që të realizohet prodhimin i kërkuar nga ky burim, që furnizoh me ujë Bashkinë Shijak dhe disa biznese që kryejnë aktivitet pranë tubacionit kryesor të këtij burimi.

**Burimi Çermës** ndërtuar në vitin 2010, ka në shfrytëzim 7 puse uji. Nga inspektimi është konstatuar se pusi nr.6, nuk funksionion pasi ka shëmbje. Gjithashtu dhe pusi nr.7 ka shëmbje dhe uji që prodhohet nga ky pus është jo cilesor, duke bërë që gjatë këtij sezoni të kemi mungesë furnizimi me ujë për qytetet Rrogozhinë, Kavajë dhe zonën turistike të Golemit. Kërkohet të bëhet pastrimi i 5 puseve ekzistuese me qëllim që të rritet sasia e ujit të prodhuar prej tyre, si dhe ndërtimi

i 2 puseve të reja duke bërë që të sigurohet rregjim sa më të mirë të stacionit të pompimit Cermë si dhe furnizim me ujë të zonave që furnizohen nga ky burim.

**Burimi Fushë Milot** ndërtuar në 2019, operon brënda kushteve teknike duke siguruar sasinë e projektuar prej 630 l/sek ujë. Evidentohen vetëm disa problematika elektro-mekanike të e-pompave, për të cilat shoqëria do marrë masa për riparimin e tyre.

**Burimet e Krujes** janë ndërtuar në vitet 1980 dhe shërbejnë për furnizim me ujë të qyteti Kruje dhe fshatave përreth. Nga inspektimi është konstatuar se gjendja e burimeve është jo e mirë dhe mungojnë rrethimi i zonës së parë të mbrojtjes S1. Burimet e Krujes përbehen nga burimet Livalla, Sakarrac, Llaspot. Depot e qytetit të Krujes: Depo Nr.1 Varrosh, Depo Nr.2 Perlat, Depo Nr.3 Gurakuq, Depo 4-5 Qender, Depo Nr.6 Isake dhe Rezervuari 7 Abaze kanë nevojë emergjente për rrethim rikonstruksion dhe vend roje

Referuar Vendim nr. 379, datë 25.5.2016 për miratimin e rregullor “Cilësia e ujit të pijshëm” Shtojca VI. Mbrojtja sanitare e burimeve të ujërave nëntokësore (Për furnizim publik ose individual) Shfrytëzimi i një kaptazhi të ri uji nëntokësor i destinuar për konsum njerëzor dhe rritja e marrjes së sasive të ujit nga një vepër ekzistuese, i nënshtrohen përcaktimit të këtyre zonave të mbrojtjes sanitare:

**zona e parë:** zona imediate ose e rreptësisë e mbrojtjes sanitare është terreni menjëherë pranë kaptazhit dhe ka për funksion kryesor të pengojë kalimin e të gjitha lëndëve ndotëse në kaptazh. Gjithë ndërtimet në këtë territor kanalizohen dhe ujërat e zeza derdhen jashtë zonës së rreptësisë në pjesën e poshtme të burimit, në gropë septike të pafiltrueshme, pastrimi i së cilës bëhet sistematikisht. Kjo është zonë e rrethuar dhe e mbyllur. Në këtë zonë ndalohet banimi ose qëndrimi i përkohshëm i personave pa autorizim dhe i kafshëve. Toka në këtë zonë nuk mbillet me asnjë kulturë bujqësore. Ajo mbillet vetëm me bar, i cili kositet herë pas here. Në periferi të kësaj zone nuk lejohet të ndërtohen varreza, fusha të përpunimit të plehut, objekte industriale që shkarkojnë ujëra të ndotura me nënprodukte nafte, lëndë kimike, toksike etj. Shtrirja e kësaj zone përcaktohet duke u bazuar në kushtet hidrogeologjike të vendburimit, karakterin, llojin dhe madhësinë e objekteve të ndryshme. Për burimin (kaptazhin), sipas formacioneve gjeologjike, kjo zonë përfshin një territor me rreze 15– 100 m.

### **Objektivi:**

- 1-Objektivi i detyrës së projektimit është hartimi i projekt-preventivit dhe zbatimit të punimeve të ujësjellësit për zonën e sipërcituar
- 2-Furnizimi me ujë i zonave 24 orë
- 3-Përmirësimi i cilësisë së ujit.
- 4-Krijimi i zonave imediate ose e rreptësisë e mbrojtjes sanitare në burimet e ujit dhe depo ekzistuese.
- 5-Permisimi i kushteve higjeno-sanitare në depot e qyteti të Krujes.

### **Qëllimi i punës:**

Për realizimin e projektit, projektuesi duhet të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me projektin që duhet të hartojë sipas detyrës së projektimit dhe të konsultohet me Sh.R UK Durrës.

Cilësia e studim projektimit duhet të jetë e tillë që të arrihet standarti i kërkuar dhe të plotësojë kushtet e projektimit. Projekti i objektit të mësipërm do të hartohet në përputhje me kërkesat e kësaj detyre projektimi dhe kushteve teknike të projektimit (KTP) dhe zbatimit (KTZ). Zbatimi i punimeve të jete sipas kushteve teknike të zbatimit dhe referuar vlerës së përcaktuar në buxhet nga Sh.R UK Durrës.

### **Kërkesat që duhet të zgjidhë projekti:**

Projekti i hartuar duhet të përmbajë:

1. Koorografine në shkallë 1:25 000. (1:10 000)
2. Projekt raport Hidrogeologjik për ndertimin e pusev dublikant.
3. Projekt ndertimi për rikonstrukcionin e depove, rrethimin e depove dhe kaptazheve.
4. Planimetrinë e depove dhe burimeve që do trajtohen në projekt.
5. Profila gjatësorë dhe tërthorë.
6. Detaje dhe hollësi të ndryshme.
7. Relacionin teknik për zgjidhjen e dhënë sipas detyrës së projektimit.
8. Llogaritjet hidraulike.
9. Llogaritjet konstruktive.
10. Përshkrimi i gjëndjes së trasesë.
11. Projekt preventivi të bëhet konform KTP dhe VKM nr.629 dt.15.07.2015 “Manuali i çmimeve të ndërtimit”, shoqëruar me analizat përkatëse.
12. Specifikimet teknike të zbatimit të projektit.
13. Grafiku i punimeve.
13. Projekt preventivi të paraqitet në tre kopjo dhe në formë dixhitale.